



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr 06 Prot

Kamëz, më 10.02.2021

V E N D I M

Nr. 05 Datë 10.02.2021

“PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË NXËNËSVE ME ARRITJE TË SHKËLQYERA NË SHKOLLAT PUBLIKE TË BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **10.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.06 Datë 05.02.2021** , në mbështetje të nenit 8, nenit 9, pika 1/ 1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 12, nenit 24, nenit 54, nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 22, nenin 23 dhe nenin 28, pika 4, shkronja “b” të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.632, datë 04.10.2004 “Për miratimin e dokumentit për politikën e decentralizimit në sektorin e arsimit parauniversitar”, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Të ofrojë mbështetjen financiare për nxënësit me arritje të shkëlqyera që ndjekin arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë në shkollat publike të Bashkisë Kamëz, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
2. **Për përfitimin e mbështetjes financiare nga Bashkia Kamëz, duhet:**
 - a. Nxënësit përfitues të kenë mbaruar vitin mësimor me **mesatare 10.00** .
 - b. Të jenë nxënës të shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë.
 - c. Të jenë fëmijë të familjeve me banim të përhershëm në Bashkinë Kamëz.
3. **Për përfitimin e mbështetjes financiare, nxënësit përfitues duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:**
 - a. Fotokopje e noterizuar e dëftesës së vitit shkollor pararendes.
 - b. Vërtetim nga drejtoria e shkollës për vazhdimin e vitit shkollor.
 - c. Çertifikatë personale me fotografi e tre muajve të fundit.
 - d. Çertifikatë e gjendjes familjare.

4. Lista e nxënësve ekselentë e dërguar nga drejtoritë e shkollave që janë nën juridiksionin e Bashkisë Kamëz hartohet nga Zyra Vendore Arsimore Kamëz.
5. Mbështetja financiare në vitin mësimor për nxënësit e shkollave publike që ndjekin arsimin e mesëm të ulët është 3000 (tre mijë) lekë në muaj dhe për nxënësit që ndjekin arsimin e mesëm të lartë është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj për 9-muaj.
6. Efektet financiare të këtij vendimi do të përfshihen në buxhetin vjetor të Bashkisë Kamëz.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/Kryetar Këshilli

Ali DAUTI

